



*Ne. 77 prot*  
*Dt. 12/12/2018*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

**V E N D I M**

**Nr. 12    Datë 11. 12. 2018**

**“PËR MOSMIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGI ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “GD-ENERGY” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika 1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim(miratim në parim) të subjektit “GD-ENERGY” SH.P.K., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

**V E N D O S I :**

- 1-Mosmiratimin në parim të kërkesës së subjektit “**GD-ENERGY**” SH.P.K me administratore Znj. Vjollca HAJDARI, për përdorim të burimit ujor, **Përroi i Leshnices dhe Dershnes**, degë të Lumit Drin për prodhim energjie elektrike në fshatin Mamëz-Surroj, Njësia Administrative Surroj, Bashkia Kukës, Qarku Kukës .
- 2- Kjo kërkesë nuk është miratuar për arsyen se ndikon negativisht në mjedis.
- 3-Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

**PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

**SEKRETAR**  
**Raimonda GURI**



**KRYETAR**  
**Çesk MILLJA**

